



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.82, datë 28.06.2021



PËR
MIRATIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË
ANËTARËVE TË KËSHILLIT VENDOR TË RINISË, SI DHE MËNYRA E
ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË TIJ

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr. 75/2019 “Për Rininë” si dhe sipas Relacionit hartuar nga Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor Durrës, si më poshtë vijon:

A. Përcaktimi i kriterëve për anëtarët e Këshillit Vendor të Rinisë

Këshilli Vendor Rinor do të përbëhet nga 6 (gjashtë) anëtar nga të cilët 3 të jenë femra dhe 3 meshkuj, këta anëtar të përfaqësojnë organizatat rinore, shoqëri civile, nxënës ekselentë nga shkolla të mesme.

Anëtarët e KRVD-së janë, si më poshtë vijon:

- a) Kryetari Bashkisë
- b) 2 (dy) përfaqësuese femra nga shkollat e mesme
- c) 2 (dy) përfaqësues meshkuj nga shkollat e mesme
- d) 2 (dy) përfaqësues nga organizata rinore dhe/ose për të rinjtë.

B. Proçedurat e përzgjedhjes së anëtarëve Këshillit Vendor të Rinisë

Për të qënë kandidat për anëtar të KRVD-së, përfaqësues i organizatave rinore, duhet të plotësojë këto kriteret:

- a) Të ketë dhënë kontribut në fushën e rinisë të paktën për 2 (dy) vitet e fundit, nëpërmjet projekteve me fokus rininë apo të zhvillimit të nismave ose të aktiviteteve për promovimin e të rinjve;
- b) Të jenë të rinj me mesatare mbi 8-të, të kenë aftësi shumë të mira komunikimi si dhe ide novative, të jenë të gatshëm të punojnë në grup.
- c) Të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore.

Kandidati, për anëtar i KRVD-së, jo përfaqësues i organizatave rinore, duhet të plotësojë këto kriteret:

- a) Të jenë të rinj me mesatare mbi 8-të, të kenë aftësi të mira komunikimi si dhe ide inovative, të jenë të gatshëm të punojnë në grup.
- b) Të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe të dispozitave ligjore në fuqi.

Kandidati, për t'u emëruar anëtar i KRVD-së, duhet të paraqesë, përkatësisht, dokumentacionin si vijon:

- a) kandidati, përfaqësues i organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë:
 - kërkesën
 - jetëshkrimin CV-në, të shoqëruar me dokumentacion.
 - vetëdeklarimin e konfliktit të interesit.
- b) kandidati, jo përfaqësues i organizatave rinore:
 - kërkesën
 - jetëshkrimin CV-në, të shoqëruar me dokumentacion.
 - letër motivimi;
 - vetëdeklarimin e konfliktit të interesit.

C. Detyrat dhe detyrimet e Këshillit Rinor Vendor Durrës

- a) Zbaton politikat dhe programet për të rinjtë
 - b) Fokuson dhe siguron që çështjet që lidhen me rininë përfshijnë të gjitha fushat e veprimtarisë së Bashkisë.
 - c) Propozon Këshillit Bashkiak përmirësimin e politikave vendore si dhe programet kryesore për mbështetjen, fuqizimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve në territor.
 - d) Harton, miraton dhe publikon thirrjet për projektpropozime drejtuar organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë.
 - e) Vlerëson gjendjen e të rinjve dhe sa janë zbatuar politikat rinore vendore nga Bashkia, duke dhënë dhe rekomandime ose dhe sugjerimet përkatëse në funksion të përmirësimit të politikave rinore nga drejtoritë respektive në Bashki.
 - f) Harton, miraton dhe publikon thirrjet për projektpropozime drejtuar organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë;
 - g) Ndjek dhe zhvillon veprimtari rinore, kulturore, artistike, letrare, sportive, të mbrojtjes së mjedisit dhe edukimin joformal, si dhe në fusha të tjera që inkurajojnë zhvillimin e të rinjve, në zbatim të politikave dhe programeve të miratuara nga ministria përgjegjëse për rininë.
 - h) Organizon takime, konferenca, fushata ndërgjegjësuere për përfshirjen e rinisë në jetën sociale, punësim e vendimmarrje.
 - i) Jep informacion ndaj të rinjve dhe/ose organizatave rinore për thirrjet për aplikime në projekte rinore të organizatave të ndryshme jofitimprurëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vendin tonë dhe atyre ndërkombëtare;
 - j) Ofron shërbime të ndryshme komunitare, nëpërmjet sigurimit të pjesëmarrjes aktive të të rinjve, për përmirësimin e jetës shoqërore në komunitetet e tyre;
 - k) Monitoron zbatimin e projekteve, që kanë përfituar mbështetje financiare.
 - l) Bashkëpunon me organizata të ndryshme rinore në nivel vendor, qendror dhe rajonal.
 - m) Ngre sipas nevojave grupe pune për çështje që lidhen me të rinjtë dhe përcakton përbërjen dhe rregullat e funksionimit të tyre.
 - n) Anëtarët e KRVD-së duhet të deklarojnë çdo rast të konfliktit të mundshëm të interesit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
 - o) Anëtarët e KRVD-së kryejnë detyrën e tyre bazuar në parimin e mosdiskriminimit, të meritës, transparencës e gjithëpërfshirjes.
 - p) Anëtarët e KRVD -së mund të japë dorëheqjen në çdo kohë, duke përfituar me shkrim Kryetarin e Bashkisë. Anëtari i dorëhequr është i detyruar të përmbushë të gjitha detyrimet e lëna deri në miratimin e urdhrin të ndryshimit.
2. Miratimin e mënyrës së organizimit dhe funksionimit të Këshillit Rinor Vendor Durrës si më poshtë vijon ;

A. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit Rinor Vendor Durrës

Këshilli Rinor Vendor Durrës është organ këshillimor, që funksionon pranë Kryetarit të Bashkisë. Këshilli Vendor i Rinisë ushtron kompetencat e mëposhtme:

- a) këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë.
- b) vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor.
- c) propozon përmirësime të politikave vendore rinore, si dhe nismat që i përshtaten nevojave të të rinjve në territorin ku veprojnë.
- d) bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Këshillin Kombëtar të Rinisë.

Misioni i KRVD-së është garantimi i mbrojtjes dhe i promovimit i të drejtave të të rinjve, nëpërmjet mbështetjes për edukim joformal, ndërveprimet e aktivizimit të rinisë dhe financimit të veprimtarive rinore, në zbatim të politikave shtetërore në fushën e rinisë.

Këshilli Rinor Vendor Durrës e shtrin veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e Bashkisë Durrës.

KRVD drejtohet nga kryetari i Këshillit Rinor, i cili organizon dhe drejton veprimtarinë e institucionit dhe përfaqëson atë në marrëdhënie me të tretët.

Thirrja për kandidatët do të publikohet në faqen e Bashkisë Durrës për një periudhë prej 30 (tridhjetë) ditësh. Përzgjedhja kryhet, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e mbylljes së aplikimeve. KRVD-ja mblidhet jo më pak se 2 (dy) herë në vit. Mbledhjet thirren dhe drejtohen nga kryetari i Këshillit Rinor, dhe sekretariati njofton anëtarët e KRVD-së, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara datës së përcaktuar për mbledhjen.

Mbledhja e KRVD-së zhvillohet kur janë të pranishëm të paktën gjysma e anëtarëve të tij. Në çdo mbledhje të KRVD-së mbahet procesverbali, që pasqyron të gjitha diskutimet gjatë mbledhjes. Procesverbali nënshkruhet nga çdo pjesëmarrës në mbledhjen përkatëse të KRVD-së.

Mandati i anëtarit të KRVD-së mbaron kur :

- a) përfundon afati dyvjeçar nga data e emërimit;
- b) humbet zotësinë juridike për të vepruar me vendim gjykate apo dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- c) jep dorëheqjen.

Anëtari i KRVD-së lirohet nga detyra, para mandatit, në rastet kur

- a) nuk paraqitet, pa shkaqe të justifikuara, në të paktën 3 (tri) mbledhje të njëpasnjëshme të KRVD-së;
- b) paraqiten shkaqe objektive, që e bëjnë të paafte për të kryer funksionet e ngarkuara;

- c) nuk përmbush detyrimet si anëtar i KRVD-së;
 - d) veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmtuar rëndë veprimtarinë dhe emrin e KRVD-së.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rini, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).


KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 29.06.2021





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 461 prot.

Durrës, më 06.07 2021



Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 82 datë 28.06.2021 “Për miratimin e kriterëve, procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Vendor të Rinisë, si dhe mënyra e organizimit dhe funksionimit të tij”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

